

PROGRAM STUDIUM I CIKLIT TË DYTË
MASTER PROFESIONAL NË INXHINIERI MATEMATIKE
PROFILI AKTUARISTIKË

Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit

1. Objektivat formuese të programit të studimit:

Drejtimi “**Inxhinieri Matematike profili Aktuaristikë**” është një drejtim që nuk përfshihet në grupin e specializimeve tradicionale të inxhinierisë. Në hartimin e kësaj kurrikule, janë pasur parasysh nevojat e reja të tregut të punës për profesionistë.

Aktuari është eksperti që analizon pasojat financiare të riskut. Nëpërmjet matematikës, statistikës dhe teorisë financiare, studion pasigurinë në ngjarjet e ardhshme. Aktuari vlerëson probabilitetin e ndodhjes së këtyre ngjarjeve dhe gjen mënyrat për të reduktuar këtë probabilitet, si dhe pasojat negative që mund të rrjedhin.

Aktuari është një nga figurat kryesore në një kompani sigurimi dhe pensionesh. Gjithashtu për kompaninë është detyrim ligjor të ketë aktuar, që në fillim të procedurave të licencimit.

Hartimi i kësaj kurrikule është bërë duke u bazuar në kurrikulat e disa universiteteve italiane, të Institutit dhe Fakultetit të Aktuarëve të Londrës, si dhe duke marrë parasysh nevojat e tregut. Aktuari që të ushtrojë profesionin në kompani sigurimesh dhe pensionesh private, duhet të pajiset me licencë. Licenca lëshohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, pas testimit dhe kalimit me sukses të këtij testimi. Studentët që mbarojnë këtë master mund të kryejnë testim për marrjen e licencës së aktuarit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

1. Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor

Ky kurs është një disiplinë relativisht e re e cila në përfundim të programit të studimit e pajis inxhinierin e ardhshëm me njohuri për:

- lidhjet e ngushta të matematikës me problemet financiare;
- llojet e ndryshme të sigurimeve
- pensionet private
- teknikat e ndryshme të sigurimeve
- metodat matematikore e statistikore të llogaritjes së primit të rrezikut
- mënyrat e tarifimit

- llogaritjen e rezervave teknike dhe matematike
- mënyrat e transferimit të rrezikut
- standartet ndërkombëtare të raportimit financiar
- vlerësimin e portofoleve të sigurimit
- legjislacionin e kompanive private dhe të pensioneve, si dhe etikën profesionale